

# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Dhjetor



01

## PËRMBYLLET THIRRJA E 9-TË E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS – CERTIFIKOHEN 435 TË RINJ

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës ka përmbyllur me sukses thirrjen e tij të nëntë, ku 435 të rinj kanë përfunduar me sukses këtë eksperiencë të vlefshme për zhvillimin e tyre profesional.

Në përfundim të programit, të rinjtë u certifikuan për zhvillimin e praktikës përgjatë 3 muajve në institucionet publike, duke dëshmuar rëndësinë e kësaj iniciative në integrimin e tyre në tregun e punës. Të rinjtë që përfunduan këtë program janë tashmë dëshmia më e mirë e suksesit të tij, duke treguar se angazhimi dhe përkushtimi janë çelësi për një të ardhme të ndritur profesionale.



02

## "UNDER 30" – DITA KOMBËTARE E RINISË FESTOHET NË SHESHIN SKËNDERBEJ

Më 8 dhjetor 2024, në kuadër të Ditës Kombëtare të Rinisë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, organizoi eventin "Under 30", duke shënuar vitin e dytë radhazi të këtij aktiviteti unik për të rinjtë shqiptarë. Përmes aktiviteteve dhe standave të ndryshme, u prezantuan 93 mundësi konkrete për angazhimin e të rinjve në çdo fushë.

Me pjesëmarrje të lartë dhe entuziazëm të dukshëm nga të rinjtë, eventi u shndërrua në një festë gjithëpërfshirëse që i dha një tjetër dimension Ditës Kombëtare të Rinisë. "Under 30" dëshmoi përkushtimin e institucioneve shqiptare për fuqizimin dhe motivimin e brezit të ri, duke hapur dyer të reja drejt një të ardhmeje më të ndritur.





# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Dhjetor



03

## SHQIPËRIA NË FORUMIN E UNESCO-S KUNDËR RACIZMIT DHE DISKRIMINIMIT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, përfaqësoi Shqipërinë në Forumin Ndërkombëtar të UNESCO-s Kundër Racizmit dhe Diskriminimit, i cili u zhvillua në Spanjë. Gjatë këtij forumi, Muzhaqi mori pjesë në Panelin Ministror, ku theksoi angazhimin e Shqipërisë në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, duke adresuar çështje që lidhen me minoritetet dhe barazinë gjinore në politikat kombëtare. Ajo veçoi rolin e rëndësishëm të të rinjve si aktorë të ndryshimit dhe mbështetjen që qeveria shqiptare ka ofruar ndaj shoqërisë civile, përmes granteve të akorduara nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Forumi shërbeu si një platformë për ndarjen e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku Shqipëria riafirmoi përkushtimin e saj ndaj iniciativave konkrete për luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.



04

## CEREMONIA E MEDALJEVE TË ARTA: 188 NXËNËS TË SHKËLQYER




Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, Ministrja e Arsimit dhe Sportit Znj. Ogerta Manastirliu, dhe Ministri e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Znj. Bora Muzhaqi, zhvilluan ceremoninë tradicionale të dhënies së "Medaljeve të Arta". Në këtë aktivitet të veçantë, 188 nxënës nga mbarë vendi, të cilët përfunduan shkollën e mesme me nota 10 absolute, u vlerësuan për punën dhe përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm.

Në fjalën e saj, Ministrja Muzhaqi përgëzoi nxënësit për suksesin e tyre dhe theksoi rëndësinë e vazhdimin të përpjekjeve për të përbushur ëndrrat e tyre. Muzhaqi nënvizoi se kjo medalje është vetëm fillimi i një rrugëtimi plot mundësi, duke i inkurajuar nxënësit të vazhdojnë përpara me guxim dhe ambicie.

Kryeministri Rama dhe Ministrja Manastirliu gjithashtu përgëzuan nxënësit dhe familjet e tyre, duke theksuar se këta të rinj janë një simbol i shpresës për një të ardhme më të ndritur për Shqipërinë. Ky aktivitet, tashmë një traditë e rëndësishme, dëshmon përkushtimin e institucioneve shqiptare për të mbështetur të rinjtë dhe për të promovuar ekselencën në arsim si një nga shtyllat kryesore për zhvillimin e vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



# DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Dhjetor



05

## DISKUTIM ME STUDENTËT E SHKENCAVE POLITIKE MBI ROLIN E TË RINJVE NË POLITIKË DHE KOMUNIKIMIN POLITIK

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, zhvilloi një takim frymëzues me studentët e Shkencave Politike, ku fokusi kryesor ishte roli i të rinjve në politikë dhe fuqia e komunikimit politik për të sjellë ndryshime të qëndrueshme.

Në një mjedis energjik dhe miqësor, Ministrja ndau rrugëtimin e saj personal, si dhe vizionin për një politikëbërje që vendos interesat qytetare mbi gjithçka dhe inkurajoi studentët të përdorin platformat digjitale për të ndarë idetë e tyre. Takimi përfundoi me një bisedë të hapur, ku studentët ndanë mendimet dhe idetë e tyre mbi përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe rolin e tyre si aktorë të ndryshimit në shoqëri.



06

## TRAJNIMI 3 DITOR "TË RINJË DHE KOMUNITETI" NË DIBËR

Në datat 21-23 dhjetor 2024, Agjencia Kombëtare e Rinisë, me mbështetjen e British Council, Ambasadës Britanike dhe UK International Development, organizoi trajnimin "Të rinjtë dhe Komuniteti" në Dibër. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të projektit "Ndërtimi i Urave, Krijimi i të Ardhmes" dhe synoi fuqizimin e të rinjve dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit mes tyre dhe komunitetit.

Gjatë tre ditëve intensive, të rinjtë pjesëmarrës u përfshinë në aktivitete që promovuan zhvillimin personal dhe profesional, duke i pajisur ata me aftësi për të kontribuar në mënyrë aktive në komunitetin e tyre. Diskutimet dhe punëtoritë trajtuan tema të rëndësishme, si ndërtimi i një të ardhmeje të qëndrueshme dhe krijimi i hapësirave për dialog e bashkëpunim mes të rinjve dhe institucioneve lokale. Ky trajnim është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të mbështetur dhe fuqizuar rininë shqiptare, duke krijuar mundësi konkrete për zhvillim dhe bashkëpunim që ndikojnë pozitivisht në shoqëri.



REPUBLIKA E SHqipërisë  
KRYEMINISTRIA  
MINISTERI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT